# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463743**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 14-vjeçari ndiqte shoqen e shkollës prej muajsh, e goditi disa herë me thikë pasi ajo e refuzoi |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/22/14-vjecari-ndiqte-shoqen-e-shkolles-prej-muajsh-e-goditi-disa-here-me-thike-pasi-ajo-e-refuzoi/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:03:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 22 shtator 2026, 12:52:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 22 shtator 2026, 12:51:00 UTC → 22 shtator 2026, 12:53:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c830877b24f261d5b169ad3659a39d1d1fcc387842e11646097b1296f817092a` |
| TEKSTI | `d8a9a6f6b11d97ff955f42ab8a02221b48a52bc3079d398622fbc7609a177b07` |
| PAMJA | `cb01eeb29b0d24a511f9082f9dd231f6b129c19bae71ee4c250ee09ac3b0e581` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5634ece2a970b0bc2ea61c5019b35e2c30277abc0e86f319363f5d30dba29738` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5634ece2a970b0bc2ea61c5019b35e2c30277abc0e86f319363f5d30dba29738`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# 14-vjeçari ndiqte shoqen e shkollës prej muajsh, e goditi disa herë me thikë pasi ajo e refuzoi

22/09/2026 14:52



**Një 14-vjeçar ka ndjekur një vajzë që e kishte refuzuar për një takim dhe më pas e ka sulmuar me thikë në një dyqan në Cirencester, Gloucestershire, në Britaninë e Madhe.**

Ngjarja e rëndë ndodhi mëngjesin e 15 marsit. Sipas të dhënave të paraqitura në gjykatë, adoleshenti ishte bërë i fiksuar pas vajzës, e cila ishte shoqe shkolle me të. Pasi ajo kishte refuzuar afrimet ndaj tij në dhjetor 2025, 14-vjeçari kishte krijuar llogari të rreme në rrjetet sociale për t'i dërguar mesazhe.

Pamjet e kamerave të sigurisë tregojnë momentin kur ai i afrohet vajzës në mënyrë të qetë dhe më pas e sulmon disa herë me thikë. Një punonjës i dyqanit ndërhyn për ta larguar agresorin nga vajza, por edhe ai goditet me thikë në shpinë.

Në pamje të tjera, vajza shihet teksa vrapon nëpër dyqan, ndërsa 14-vjeçari e ndjek pas, ende i armatosur. Ajo arrin të dalë nga dyqani dhe kërkon ndihmë në një banesë aty pranë.

Vajza pësoi plagë në qafë, duar dhe fytyrë, si dhe dëmtime në shpinë. Pas sulmit, adoleshenti u largua nga vendngjarja, por u ndalua pak më vonë nga policia pranë zonës. Gjatë kontrollit, policia i gjeti një thikë në xhepin e pantallonave.

Në gjykatë u bë e ditur se 14-vjeçari, i cili për arsye ligjore nuk mund të identifikohet, kishte pranuar fajësinë për plagosje me dashje, shkaktim të dëmtimeve të rënda trupore pa dashje dhe mbajtje të një arme të ftohtë në një vend publik.

Ai u dënua me një urdhër referimi 12-mujor dhe një urdhër ndalimi kontakti prej tre vitesh. Në deklaratën e saj për gjykatën, vajza tha se pas sulmit ndihet e frikësuar dhe se edhe lëvizjet e papritura të njerëzve e bëjnë të trembet.

Ajo tregoi gjithashtu se ka makthe të përsëritura për sulmin dhe se ngjarja ka ndikuar në mënyrën se si ajo lëviz dhe ndihet e sigurt në zonën ku jeton.

*"Jam e frikësuar dhe nervoze kudo që shkoj"*, tha vajza në deklaratën e saj.

Detektivi Ian Fletcher, drejtues i hetimeve për çështjet serioze dhe komplekse në policinë e Gloucestershire, e cilësoi ngjarjen si një sulm të dhunshëm të kryer në mes të ditës.

Ai tha se vajza kishte qenë "shumë, shumë me fat" që kishte shpëtuar me plagë të konsideruara të lehta, duke shtuar se ngjarja mund të kishte përfunduar në mënyrë fatale.

**Top Channel**

## Bota »

## Kryesore



**"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë**
18:25

**"Kontakte telefonike si bashkëpunëtor i shërbimit", zbardhet dëshmia e Vlora Hysenit për lidhjet me Ergys Agasin tre ditë para arrestit**
15:11

**Një vit krim në seri në Sarandë/ Ministri i Brendshëm kërkoi shkrirjen e zinxhirit komandues, Feliks Hoda largohet nga drejtimi i komisariatit, ja kush e zëvendëson**
16:21

**El Niño i fuqishëm mund të shkaktojë 451 mijë vdekje nga nxehtësia në gjashtë muaj, cilat vende janë më të rrezikuar**
16:21

**I akuzuar për përdhunim tre vite më parë, ylli i PSG-së del përpara gjykatës**
17:16

## Më të lexuarat

**Kryeministri Rama komandon drejtuesin e ri të SHISH pas shkarkimit të Vlora Hysenit**

**"Pinte kafe çdo javë me ish-kreun e SPAK te zyra e tij"/ Urdhër-arresti ndaj Vlora Hysenit, gazetari Qyno në 'Top Story': Dumani hetoi edhe Fatos Klosin, por ai mori pafajësinë**

**"Bela me Taon janë shokë, do bëhët kryetar Kuvendi", zbardhen SMS-të mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit në dosjen e SPAK**

**"Kontakte telefonike si bashkëpunëtor i shërbimit", zbardhet dëshmia e Vlora Hysenit për lidhjet me Ergys Agasin tre ditë para arrestit**

**"Urgjenca e SPAK-ut për ta bërë publik arrestimin fsheh një hall të madh"/ Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë**

**"Tao kryetar Kuvendi, Skënderi më thirri me u taku"/ Mesazhet e Vlora Hysenit me Ergys Agasin zbulojnë klanin e Belinda Ballukut në PS dhe Polici**

**36-vjeçari shqiptar u vra në Itali teksa po vidhte, flet bashkëshortja: Djali im nuk ka më baba dhe unë jam e shkatërruar**

**Dokumenti/ Emri i Vlora Hysenit në dekretin francez për Urdhrin Kombëtar të Meritës, ish kreu i SHISH mes të huajve të propozuar për**

## Bota »



"Kur i jepni Rusisë para, i jepni më shumë kohë luftës"/ Zelensky bën thirrje nga OKB: Rrisni presionin ndaj Moskës

23/09 21:01



Përpjekja për uljen e çmimit të energjisë në tregun vendas, Trump përgatit planin për të ndaluar eksportet e naftës së papërpunuar nga SHBA

23/09 20:11



40 vjet pas Çernobilit, Senati italian i jep dritën jeshile ligjit të ri për energjinë bërthamore

23/09 18:54



Nga strehimi te spitalet, arsimi dhe teknologjia/ Këshilli i Paqes i Trump zbulon planin për rimëkëmbjen e Gazës, 2.45 miliardë dollarë financim

23/09 18:07



"Punon pa pushim, nga mëngjesi në darkë"/ Jeta si bashkëshortja e Presidentit të SHBA-së, rrëfehet Melania Trump

23/09 17:11



Itali, 44-vjeçari shtirej si gjinekolog dhe u kërkonte pacienteve foto e video intime

23/09 16:51

gradën "Kalorës"

"SPAK u nxitua me arrestin", eksperti i sigurisë, Xhavit Shala: Prokuroria e Posaçme duhej të vepronte ndryshe me kreun e SHISH, ndoshta me dorëheqje

A është gjetur Bleona Mata pas 16 vitesh? Përplasje LIVE mes nënës dhe avokatit në "Ftesë në 5": Do të të ndjek penalisht

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Thesaret nën ujë ende të pazbuluara, ekspertët: Të rikthehen ekspeditat




Top Channel/ Mbledhja e kryesisë së PD, Berisha i mbledh në seli për qëndrimin që do mbajë opozita



Top Channel/ Frenon çmimi i banesave, duhen më shumë muaj për të shitur një apartament



Top Channel/ "Gati të flasim me Trump", Pezeshkian deklaroi në OKB se nuk janë terroristë



Top Channel/ Kushtetuesja konfirmon qeverinë! Kosovë, afat deri më 6 tetor për presidentit



Top Channel/ Përshkallëzohet bojkoti i avokatëve, kundërshtojnë rregulloren e GJKKO



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.